



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:236616
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05527071

A.C.nr.3147/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit, R.M., nga Komuna Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K, avokat, me seli në rruga "...", banesa ..., Komuna Prishtinë kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Rr. "Lidhja e Pejës", Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Diellza Hajdari, juriste e diplomuar, në çështjen kontestimore për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, dhe paditësit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1673/15 datë 08.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e paditësit R.M., nga Komuna Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1673/15 datë 08.02.2021, dhe gjykohet si vijon: **PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit R.M., nga Komuna Prishtinë, si e bazuar, **DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Rr. "Lidhja e Pejës", Komuna Prishtinë, t'i paguaj paditësit R.M., nga Komuna Prishtinë, në emër të kompensimit të dëmit për aksidentin e ndodhur me datë 17.06.2015, dhe atë për frikë të përjetuar shumen prej 1.000,00€uro(Njëmijëeuro), dhe për të gjitha llojet e dhimbjeve trupore shumen prej 1.400,00 €uro (Njëmijëekatërqind euro), ndërsa pjesa tjetër përtej shumës së gjykuar për dhimbje trupore – fizike, dhe për frikë, **REFUZOHET E PA BAZUAR**.

II. REFUZHET e pathemeltë ankesa e të paditurës, dhe paditësit sa i përket vendosjes në pjesën tjetër të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1673/15 datë 08.02.2021, dhe i njëjti, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.1673/15 datë 08.02.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon: “... **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, R.M., nga Prishtina.

I. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit “BKS”, me seli në Prishtinë, që paditësit, R.M., nga Prishtina, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 17.06.2015, t’ia paguajë shumat dhe atë:

- Në emër të dëmit material dhe jo material:
- Për dhimbjet fizike, shumën prej1.200 euro
- Për shkak të frikës së përjetuar, shumën prej800 euro
- Për ushqimin e përforcuar dhe ndihmën e personit të huaj, shumën prej..... 70 euro
- Për ndihmën e huaj, shumën prej..... 70 euro

II. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit “BKS”, me seli në Prishtinë, që paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi t’ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datë 08.02.2021 e deri në pagesën definitive, për pjesën e gjykuar të kompensimit, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 594 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

III. REFUZHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësit R.M., nga Prishtina, përtej shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit material dhe jo material dhe atë për: për dhimbjet fizike, shumën prej 300 euro, për shkak të frikës së përjetuar, shumën prej 200 euro, për ushqimin e përforcuar 130 euro, për ndihmën e personit të huaj, shumën prej 130 euro, si dhe në tersi është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për shpenzimet e shërimin – rehabilitimit, në shumë prej 300, si e pabazuar...”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditësi, për shkak të: konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që ta aprovojë ankesën e të paditësit si të bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në drejtim të rritjes së shumës së kompensimit.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- **Ankesa e të paditësit, është pjesërisht e themeltë;**
- **Ankesa e të paditurës është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi R.M. nga Komuna Prishtinë, me datë 16.07.2016, përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi ndaj të paditurës, Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Komuna Prishtinë, me kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 08.02.2021, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, dëgjimit të ekspertëve mjekësor, marrjes së mendimit nga eksperti i komunikacionit, dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.1673/15 datë 08.02.2021, me të cilin e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...Gjykata duke vërtetuar në mënyrë të padyshimtë gjendjen faktike me prova material dhe duke u bazuar në nenin 136 të LMD-së, në të cilën parashihet se baza e përgjegjësisë i bie atij që e shkakton dëmin dhe i cili ka për detyrë ta kompensoi dëmin në qoftë se nuk provohet se dëmi ka lindur pa fajin e tij, që në rastin konkret dëmi ka lindur me fajin e të siguruarit të paditurës. Duke vlerësuar pretendimet e paditësit dhe kundërshtimet e të paditurës, gjykata duke ju referuar nenit 169 të LMD-së, i cili parasheh se personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendos gjendjen e ekzistuar para se të shkaktojë dëmin. Mirëpo kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur konsiderohet se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, që në rastin konkret personi përgjegjës ka pas mbulesë të sigurimit për automjetin e tij tek e paditura andaj gjykata cakton që për dëmin respektivisht për të gjitha format e dëmit të pësuar paditësit, është e detyruar që këtë të t’ia paguaj dëmtueses respektivisht e paditura në këtë rast konkret në shumën përkatëse në të holla për efektin e kompensimit të dëmit siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Me dispozitën e nenit 179 të LMD-së, parashihet që: “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”...”.*

Vlerësimin juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj pjesërisht i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit duke e marrë parasysh lëndimet e pësuara të paditësit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se shuma e kompensimit të dëmit të gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë sa i përket kompensimit në emër të dëmit jo material për dhimbjet e pësuara, dhe për frikën e përjetuar, është e ultë andaj edhe e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar, duke gjykuar që paditësit R.M., nga Prishtina t'ia njoh në emër të dëmit jo material për dhimbje trupore shumë prej 1.400,00 Euro, (njëmijëekatërqindeuro), dhe për frikë shumë prej 1.000,00 (njëmijëeuro) duke u bazuar edhe në mendimin dhe konstatimit e ekspertëve mjekësor Dr. A.F., ortopedë, dhe Dr.S.G. - B, psikiatër të cilët në mendimin e dhënë kanë konstatuar se paditësi R.M. në aksidentin e datës 17.06.2015, ka përjetuar dhembje fizike të intensitetit të lartë që kanë zgjatur 48 orë, të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur për 15 ditë, të intensitetit të ultë, ndërsa ekspertja Dr.S.G-B, psikiatër ndër të tjera ka konstatuar se paditësi R.M. në aksidentin e datës 17.06.2015, ka përjetuar frikë primare që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare e intensitetit të lartë që ka zgjatë 48 orë, frikë sekondare e intensitetit mesatar dhe më të ultë e cila ka zgjatë për 2 deri 4 muaj.

Në nenin 323 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore në mënyrë decisive thuhet se *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tilla do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si reale shumë sa i përket vendosjes së kompensimit të paditësit për ushqimin e përforcuar, ndihmës së personit të tretë, ku edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, pasi në bazë të mendimit të ekspertit mjekësor, i cili ka vlerësuar se paditësi R.M. ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, në kohëzgjatje prej 15 ditë, dhe ndihmën e personit në kohëzgjatje prej 10 ditë andaj këtë pjesë edhe e ka vërtetuar, si reale dhe të drejtë.

Në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decisive thuhet se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*.

Ndërsa në nenin 179 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndër të tjera thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë...”*.

Pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është pretendim i pa bazuar pasi që dispozitivi i Aktgjykimit është i kuptueshëm, i kuartë dhe arsyetimi i Aktgjykimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Pretendimi ankimor i të paditurës se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar bazën e përgjegjësisë së të paditurës ky pretendim është i pa bazuar pasi që e paditura në seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatë me datë 08.02.2021 ndër të tjera ka deklaruar se *"...Fillimisht lidhur me bazën juridike deklaroi se sa i përket rrjedhjes së aksidentit nuk është kontestuese...Konfirmoj se e kam pranuar ekspertizën mjeksore të dt.23.10.2020 për të cilën nuk e kundërshtoj dhe nuk kam vërejtje..."*.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), dhe e), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.3147/2021 datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi